



UNIVERSITETI " FAN S . NOLI "
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
KORÇË

PROGRAMI I SIMPOZIUMIT
“NDIHMESAT E PEDAGOGËVE DOKTORANTË NË FUSHËN E EDUKIMIT DHE TË
FILOLOGJISË”

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë ka një numër të konsiderueshëm pedagogësh efektivë dhe të ftuar që kanë mbrojtur disertacionin, që janë duke vazhduar shkollën doktrale apo që do të mbrojnë doktoraturën së shpejti. Promovimi i arritjeve të këtyre pedagogëve është një detyrë e rëndësishme e drejtuesve të departamenteve dhe të fakultetit.

Duke u nisur nga ky fakt, Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë e gjen të arsyeshme organizimin e një simpoziumi, ku pedagogët doktorantë do të shpalosin para një auditori të specializuar ndihmesat e tyre në fusha të ndryshme të edukimit dhe të filologjisë. Në këtë konferencë do të ftohen të marrin pjesë dhe gjithë udhëheqësit e doktorantëve, të cilët do të jenë me cilësinë e këshillit shkencor të konferencës dhe botimit të kumtesave.

Po ashtu, në këtë konferencë do të marrin pjesë dhe rreth 20 studentë të huaj që mësojnë gjuhën shqipe, si një veprimtari për njohjen dhe promovimin e Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë në universitete të tjera.

Të gjithë pjesëmarrësve u është dërguar ftesa e mëposhtme:

Për të paraqitur punimet më të spikatura të pedagogëve doktorantë, në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për të gjithë profesorët udhëheqës, Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, organizojnë:

SIMPOZIUM SHKENCOR

“NDIHMESAT E PEDAGOGËVE DOKTORANTË NË FUSHËN E EDUKIMIT DHE TË
FILOLOGJISË”

Simpoziumi do të mbahet më 19 shtator 2014, ora 17⁰⁰, në sallën e Amfiteatrit, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë.

Në emër të Rektoratit të Universitetit “Fan S. Noli” dhe të Këshillit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, ju ftojmë të merrni pjesë në këtë veprimtari, duke vlerësuar punën tuaj të çmuar, ndihmën e pakursyer dhe dashamirësinë e treguar për kualifikimin shkencor dhe përngritjen intelektuale të pedagogëve të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin e Korçës.

Në simpozium do të përurohet dhe periodiku “VJETARI SHKENCOR-FEF” (botim i veçantë i Buletinit Shkencor të Universitetit “Fan S. Noli”), ku janë botuar punimet e 35 pedagogëve doktorantë.

Pjesëmarrja Juaj do të jetë një kënaqësi dhe nderim për të gjithë.

Me respekt,

Prof. as. dr. GJERGJI MERO, Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”

Prof. dr. ALI JASHARI, Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

PROGRAMI

SEANCA PLENARE, ORA 17, SALLA E AMFITEATRIT

1. Fjalë mirëseardhjeje- prof. dr. ALI JASHARI, dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë
2. Përshëndetje-prof. as. dr. GJERGJI MERO, rektor i Universitetit “Fan S. Noli”
3. Përshëndetje-Rektorati i Universitetit të Tiranës
4. Përshëndetje-prof. dr. SHEZAI RROKAJ, dekan i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës
5. Përshëndetje-prof. dr. KLAUDETA DIBRA, dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
6. Përshëndetje-prof.dr. THEODHORI KARAJ, dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Universiteti i Tiranës
7. Përshëndetje-prof. dr. VALTER MEMISHA, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, QSA, Tiranë

SESIONE PARALELE, ORA 18-19

EDUKIM, MËSIMDHËNIE (Qendra e Ekselencës)

Drejtues të seancës: Doc. DONIKA DARDHA, prof. dr. BARDHYL MUSAI, prof. dr. ANDREW GOODSPEED, prof. dr. SHPRESA DELIJA, prof. as. dr. ANDROMAQI HALOCI, prof. dr. DRITA HADAJ

Kumtesa:

- ARJAN KAMBURI

Takimi interkulturor. Prespektiva teorike dhe praktika sociale (master i shkencave në psikologji)

- DONIKA DARDHA

Identifikimi i vështirësive të të nxëniet në arsimin fillor dhe ndikimi i tyre në gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta edukimi (NVE) në klasa normale (udhëheqës prof. dr. Bardhyl Musai, Tiranë)

- DORELA KAÇAUNI -KONOMI

Mësimdhënia e gramatikës së gjuhës angleze te nxënësit e klasës së tretë. Zbatimi i drejtimit deduktiv dhe induktiv (udhëheqës prof. dr. Shpresa Delija, Tiranë)

▪ **EDLIRA XEGA**

Aspekti kulturor në mësimdhënien e gjuhës angleze në kontekstin shqiptar (udhëheqës prof. dr. Drita Hadaj, Tiranë)

▪ **EVIONDA PYLLI**

Aspekte të shfaqjes së komunikimit në klasë në funksion të një mësimdhënieje efektive në arsimin fillor (udhëheqës prof. dr. Ali Jashari, Korçë)

▪ **JULIANA ÇYFEKU**

Përdorimi i korporave në mësimdhënien e gjuhës angleze në auditor (udhëheqës prof. dr. Andreë Goodspeed , UEJ, Tetovë, Maqedoni)

▪ **LINDITA KAÇANI**

Analizë e strategjive të përdorura në vendin tonë në mësimin e gramatikës së gjuhës angleze (udhëheqës prof. dr. Ilo Stefanllari, Tiranë)

▪ **OLSA PEMA**

Aktualizimi i parimeve pedagogjike dhe pragmatika e ligjërimit në materialet dëgjimore në mjediset virtuale (udhëheqës prof. as. dr. Andromaqi Haloci, Tiranë)

GJUHËSI (salla e Amfiteatrit)

Drejtues të seancës: prof. as. dr. ELONA ÇEÇE, prof. dr. DHIMITRI BELLO, prof. dr. ILO STEFANLLARI

Kumtesa:

▪ **ALBINA PAJO**

Përkufizimi i konceptit të fjalisë dhe llojeve të saj në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar (udhëheqës prof. dr. Ali Jashari, Korçë)

▪ **ALDA CICKO**

Analiza e kompozitave nga pikëpamja e motivimit të brendshëm (udhëheqës prof. dr. Shezai Rrokaj, Tiranë)

▪ **ALMA POGONI**

Teoria e akteve të të folurit. Shqyrtim teorik (udhëheqës prof. dr. Shezai Rrokaj, Tiranë)

▪ **DANIELA STOICA**

Aspekte të bilinguizmit në të folmen e femrave arumune nga Korça. Bashkëpërkime leksikore dhe frazeologjike (udhëheqës prof. dr. Nicolae Saramandu, Rumani)

▪ **EDIOLA NASE**

Aspekte teorike të retorikës përmes shembujve praktikë (udhëheqës prof. dr. Valter Memisha, Tiranë)

▪ **LIRI SEITLLARI**

Pasuria sinonimike në veprën e Kutelit (udhëheqës prof. dr. Ali Jashari, Korçë)

- **LORENA ROBO**

Vështtrim përmasës i njësive frazeologjike me vatër semantike me pjesë të trupit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe (udhëheqës prof. dr. Ilo Stefanllari, Tiranë)

- **MIGENA RIZA**

Mënyrat e fjalëformimit në leksikon e gjellëtarisë (udhëheqës prof. dr. Dhimitri Bello, Tiranë)

- **OLGER BRAME**

Rreth ndihmesave teorike në fushën e semiotikës (udhëheqës prof. dr. Valter Memisha, Tiranë)

- **SUELA KOÇA**

Përkthimi i togfjalëshave të qëndrueshëm idiomatikë nga anglishtja në shqipe (udhëheqës prof. dr. Ali Jashari, Korçë)

HISTORI –GJEOGRAFI (salla 325)

Drejtues të seancës: prof. as. dr. BASHKIM JAHOLLARI, prof. dr. VALENTINA DUKA prof. dr. EQEREM YZEIRI, prof. dr. VASIL TROJANI, prof. dr. PETRIT NATHANAILI, prof. dr. LORENC BEJKO, prof. as. dr. EVA HYSKAJ

Kumtesa:

- **ADELINA NEXHIPI**

Polarizimi politik dhe krizat politike në Shqipëri (udhëheqës prof. as dr. Eva Hyskaj, Tiranë)

- **ALBA KREKA**

Ndikimi i Revolucionit Kulturor Kinez në shoqërinë shqiptare (udhëheqës prof. dr. Petrit Nathanaili, Tiranë)

- **DORIAN KALLANXHI**

Besimi në neolit në Shqipëri (udhëheqës prof. dr. Lorenc Bejko, Tiranë)

- **EDLIRA MENKSHI**

Integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik rajonal dhe lokal. Rasti i qarkut të Korçës (udhëheqës prof. dr. Eqerem Yzeiri, Tiranë)

- **EFTIOLA THANAS**

Elemente dekorativo-arkitektonike të banesave në gjysmën e parë të shekullit XX në qytetin e Korçës (udhëheqës prof. dr. Lorenc Bejko, Tiranë)

- **ERMIRA JASHIKU**

Vlerat dhe risqet gjeologjike në zonën Korçë- Devoll (udhëheqës prof. dr. Vasil Trojani, Tiranë)

- **METIN VENXHA**

Historia ekonomike e Shqipërisë ndërmjet viteve 1920-1939 (udhëheqës prof. dr. Gaetano Sabatini, Itali)

- **ORJON AGO**

Kosova, lufta për çlirim dhe e drejta për të patur shtet (udhëheqës prof. dr. Petrit Nathanaili, Tiranë)

- **RUELA AGO**

Zgjedhjet elektorale të vitit 1945 në Shqipëri (udhëheqës prof. dr. Valentina Duka, Tiranë)

LETËRSI (Biblioteka e fakultetit)

Drejtues të seancës: prof. as. dr. PAVLLO CICKO, prof. dr. DHURATA SHEHRI, prof. dr. VIKTOR RISTANI, prof. dr. MAKS DAIU, prof. dr. ILIA LËNGU, prof. dr. KRISTAQ JORGO

Kumtesa:

- **ALMA KARASALIU**

Roli i rrëfimitarit në veprat e shkrimtarit Xhonatan Suift (udhëheqës prof. dr. Viktor Ristani, Tiranë)

- **BENITA STAVRE**

Shqipëria dhe shqiptarët gjatë viteve 1921-1939 në shkrimet e autorëve anglezë (udhëheqës prof. dr. Gëzim Hadaj, Tiranë)

- **ERINDA PAPA**

Psikologjia e gruas në procesin e plakjes – një nga shqetësimet e vazhdueshme të Doris Lesingut (udhëheqës prof. dr. Maks Daiu, Tiranë)

- **ERIOLO BONJA- QAFZEZI**

Përkthimi i letërsisë për fëmijë në aspektin teorik dhe praktik (udhëheqës prof. dr. Viktor Ristani, Tiranë)

- **ERIS RUSI**

Dimensionet e fantastikes në letërsinë shqipe të shekullit XX (udhëheqës prof. dr. Dhurata Shehri, Tiranë)

- **FABIOLA KADI**

Poezia fetare franceze gjatë epokës moderne (udhëheqës prof. dr. Ilia Lëngu, Tiranë)

- **ILIR SHYTA**

Teoritë receptive në veprën e Lasgush Poradecit. Receptim përmes një pyetësi (udhëheqës prof. dr. Dhurata Shehri, Tiranë)

- **NELI NAÇO**

Mesianizmi në rrëfimet e Mitrush Kutelit (udhëheqës prof. dr. Kristaq Jorgo, Tiranë)